



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit  
Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zashtitu Okoline  
Department for Urbanism, Planning and Environmental Protection

# RAPORTI TREMUJOR I PUNËS

JANAR-MARS 2026

**DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOVOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbr. i Mjedisit  
Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredine

-XII- Nr. i prot. 74 Më 03.04.2026  
Br. RAHOVEC - ORAHOVAC

## DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna në përputhje me dispozitat ligjore, duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, si dhe Statuti i Komunës Nr. 1005, datë 29.03.2017.

Ky raport paraqet aktivitetet e realizuara gjatë periudhës Janar – Mars 2026 nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionojnë dy sektorë:

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit janë pranuar gjithsej 74 kërkesa të ndryshme, prej tyre 68 në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit dhe 8 kërkesa në sektorin e Mjedisit. Ndërsa janë zgjidhur gjithsej 67 lëndë.

Të hyrat buxhetore në DUPMM (tremujori i parë) për vitin 2026

| Viti                | 2025    | 2026    |
|---------------------|---------|---------|
| Të hyra Janar- Mars | 5981.14 | 9954.88 |

### SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në vitin 2026 zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit nga sektori për Urbanizëm dhe Planifikim janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve, investitorëve. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban brenda afatit ligjor janë trajtuar kërkesat, janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, sipas Plani Zhvillimor Komunal në fuqi. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese të cilat janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës, me ç' rast është bërë kontrollimi i tyre. Po ashtu janë dhënë edhe pëlqime. Me vendim të kryetarit të datës 15.09.2022 janë emëruar dy zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe kushtet e ndërtimit.

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë shqyrtuar:

| <b>Janar - Mars 2026</b> |                 |                 |                 |                    |               |
|--------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|--------------------|---------------|
| <b>Kërkesat</b>          | <b>Nr.total</b> | <b>Aprovuar</b> | <b>Refuzuar</b> | <b>Në shqyrtim</b> | <b>Hudhet</b> |
| Leje ndërtimi            | 10              | 8               | 0               | 2                  | 0             |
| Leje përdorimi           | 3               | 3               | 0               | 0                  | 0             |
| Leje rrënimi             | 5               | 5               | 0               | 0                  | 0             |
| Kushte ndërimore         | 20              | 11              | 0               | 9                  | 0             |
| Kërkesë                  | 21              | 11              | 3               | 7                  | 0             |
| Vërtetim Urbanistik      | 8               | 5               | 2               | 1                  | 0             |
| Legalizim i objekteve    | 1               | 1               | 0               | 0                  | 0             |
| <b>Gjithësej</b>         | <b>68</b>       | <b>44</b>       | <b>5</b>        | <b>19</b>          | <b>0</b>      |

Të hyrat e përgjithshme Janar - Mars 2025

|                           |                 |
|---------------------------|-----------------|
| Parallogaria              | 5190.74€        |
| Vërtetim –Pelqim          | 600€            |
| <b>Totali i të hyrave</b> | <b>5790.74€</b> |

